

Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*
Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*

Ankesa Nr: 30562/04, 30566/04
Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*
Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*

Ankesa Nr: 30562/04, 30566/04
Shteti: *Mbretëria e Bashkuar*

Përgjegjës
Data e vendimit: 4 dhjetorit 2008

Organi vendimmarrës

Thelbi i vendimit

Nenent e KEDNJ: *Neni 8*
Neni 14
Neni 41

Link në HUDOC

Fjalëkyçe për kërkim në HUDOC

Jurisprudenca e cituar

Buletini II

S. dhe MARPER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ruajtja nga ana e autoriteteve e të dhënave mbi shenjat e gishtërinjëve, analizave të gjakut dhe ADN të të pandehurve edhe pasi ata janë deklaruar të pafajshëm nga gjykatat konsiderohet në shkelje të të drejtave të Konventës.

Shkelje e nenit 8
Nuk ka nevojë të ekzaminohen pretendimet e nenit 14
Akordim shpenzimesh dhe kostot
<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/vieë.asp?action=html&documentId=843941&portal=hbkm&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

"INTERFERENCE-{ART 8}" "MARGIN OF APPRECIATION" "NECESSARY IN A DEMOCRATIC SOCIETY-{ART 8}" "PRESCRIBED BY LAË-{ART 8}" "PREVENTION OF CRIME-{ART 8}" "PROPORTIONALITY "RESPECT FOR PRIVATE LIFE"
Amann v. Sëitserland [GC], no. 27798/95, § 56 and § 69, ECHR 2000-II ; Asan Rushiti v. Austria, no. 28389/95, § 31, 21 March 2000 ; Association for European Integration and Human Rights and Ekimdzhiev v. Bulgaria, no. 62540/00, §§ 75-77, 28 June 2007; Burghartz v. Sëitserland, 22 February 1994, § 24, and opinion of the Commission, p. 37, § 47, Series A no. 280-B ; Christine Goodëin v. the United Kingdom [GC], no. 28957/95, § 120, ECHR 2002-VI ; Connors v. the United Kingdom, no. 66746/01, § 82, 27 May 2004 ; Coster v. the United Kingdom [GC], no. 24876/94, § 104, 18 January 2001 ; Dickson v. the United Kingdom [GC], no. 44362/04, § 78, ECHR 2007 ; Evans v. the United Kingdom [GC], no. 6339/05, § 77, ECHR 2007 ; Friedl v. Austria, judgment of 31 January 1995, §§ 49-51, Series A no. 305-B, opinion of the

Faktet dhe pretendimet

Ankuesit janë me kombësi Britanike, të lindur përkatësisht në vitin 1989 dhe 1963. Cështja konsistonte në ruajtjen nga ana e autoriteteve të të dhënave mbi shenjat e gishtërinjëve të ankuesve, kampioneve të qelizave dhe profilit të ADN-së, edhe pas përfundimit të procedimit penal kundër tyre, ku ata u shpallën të pafajshëm.

Bazuar në nenin 64 të Dekretit të Policisë dhe Evidencave Kriminale të vitit 1984 (PACE), shenjat e gishtërinjëve dhe kampionet e ADN-së që i merren një personi të dyshuar për një veprë

penale mund të ruhen pa një limit kohor, edhe në qoftë se procedurat penale pasuese mund të përfundojnë me shpalljen e pafajsisë së personit në fjalë.

Në çështjen e paraqitur në Gjykatë, të dy ankuesit ishin akuzuar për vepra penale por nuk ishin denuar. Ankuesi i parë, një i mitur 11-vjecar, ishte shfajësuar nga akuza për tentativë vjedhje, ndërkohë që çështja tjetër kundër ankuesit të dytë në lidhje me ngacmime karshi partnerit të tij, u pezullua zyrtarisht pasi çifti u pajtua.

Bazuar në faktin që ankuesit nuk u denuan, ata kërkuan shkatërrimin e shenjave të gishtërinjve dhe kampioneve të qelizave, por në të dy rastet policia refuzoi. Ankesat e tyre për një rishikim gjyqësor në lidhje me refuzimin, nuk u pranua as në një vendim që u apelua më pas.

Duke dhënë gjykimin kryesor në Dhomën e Lordëve, Lordi Steyn përmendi se edhe nëse pretendohet se kishte patur ndërhyrje në jetën private të ankuesve, kjo ishte shumë modeste dhe në proporcion me qëllimin pse ishte bërë, sepse materialet mbaheshin vetëm për qëllime të kufizuara dhe nuk mund të perdoreshin pa një krahasues në skenën e krimin, ndërkohë që një database e zgjeruar përbën një avantazh të madh në luftën kundër krimeve të rënda.

Ankuesit në GJEDNJ pretenduan shkelje të neneve 8 dhe 14 të Konventës, në lidhje me mbajtjen nga ana e autoriteteve të shenjave të gishtërinjve, kampioneve të qelizave dhe ADN-së pas shpalljes së pafajësisë së tyre.

Komente mbi Vendimin e Dhomes se Madhe

Me vendim unanim, trupi gjyqësor që përbëhej nga shtatëmbëdhjetë gjykatës të GJEDNJ vendosi që kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës dhe akordoi një dëmshpërblim prej 42,000 Euro për secilin ankues. Gjykata duke pasur parasysh analizën e saj në kuadrin e nenit 8 vendosi se nuk ishte e nevojshme të analizonte nëse ruajtja e kampionit të ADN-së ishte gjithashtu shkelje e nenit 14 (ndalimi i diskriminimit). Në kuadrin e masave të përgjithshme Gjykata vuri re se praktika e vendeve anëtare të KE por edhe në vetë Mbretërinë e Bashkuar ishte e ndryshme në lidhje me ruajtjen e të dhënave. Kështu, në pjesën tjetër të Mbretërisë së Bashkuar, sidomos në Skoci, ishte dhënë një shembull i një përjasje më racionale dhe proporcionale referuar ruajtjes së ADN-se, në këto raste kampionet e ruajtura duhet të shkatërroreshin nëse personi shpallej i pafajshëm; megjithatë ekziston një mundësi ku autoritetet mund ti ruajnë kampionet nëse individ është i dyshuar për ngacmime seksuale ose ushtrim dhune (Retention Guidelines for Nominal Records on the Police National Computer 2006).

Duke u bazuar në këtë vendim, GJEDNJ ka zhvilluar më tej strukturën e saj të jurisprudencës në lidhje me masat që mund të konsiderohen se tejkalojnë kuadrin e vleresimit të shtetit. Gjykata vendosi që, midis shteteve anëtare ku nuk kishte konsensus përse i përket rëndësisë së një çështjeje, limiti duhet të jetë më i gjerë, megjithatë, duke qënë se faktet në këtë rast përfshijnë ndërhyrje në të dhënat personale të një rëndësie të vecantë për individin, limiti i lejuar për shtetin ishte minimal dhe Mbretëria e Bashkuar nuk kishte ruajtur ekuilibrin e duhur.

Konkretisht GJEDNJ në analizën e pretendimeve të ankuesve theksoi se :

Pretendimi për shkelje të nenit 8 të KEDNJ: Gjykata vuri re se *kampionet e qelizave* përmbanin një informacion mjaft të ndjeshëm rreth një individ, përfshirë edhe informacion për shëndetin e tij. Vec kësaj, kampionet përmbanin kodin gjenetik unik të individit, i cili ka një rëndësi të vecantë për personin në fjale dhe të afërmit e tij. Nisur nga natyra dhe sasia e informacionit sensitiv që përmbanin kampionet e qelizave, ruajtja e tyre u konsiderua se duhej të analizohet në kuadrin e të drejtës për respektimin e jetës private të personave të interesuar, garantuar nga neni 8 i Konventës.

Nga pikëpamja e Gjykatës, kapaciteti i *profilit të ADN-së* për të siguruar një mënyrë për identifikimin e lidhjeve gjenetike midis individëve, ishte ne vetvete e mjaftueshme për të arritur në përfundimin që ruajtja e tyre interferonte me të drejtën për respektimin e jetës private të këtyre individëve. Mundësia e krijuar nga profilet e ADN-së për të nxjerrë konkluzione rreth origjinës etnike bën që ruajtja e tyre të jetë akoma më sensitive dhe në rrezik për të ndikuar tek e drejta për respektimin e jetës private.

Gjykata arriti ne përfundimin se ruajtja e kampioneve të qelizave dhe ajo e profileve te ADN-së përbënte një ndërhyrje ne respektimin e të drejtës së jetës private të ankuesve, referuar nenit 8 § 1 të Konventës.

Gjurmët e gishtërinjëve të ankuesve ishin marrë në kontekstin e procedimeve penale dhe më pas të regjistruara në një databazë gjithëkombëtare për ruajtjen e tyre permanente dhe përpunimin në mënyrë të rregullt nga mjete të automatizuara me qëllim identifikimin kriminal.

Ishte pranuar në paragrafet mësipër që, për shkak të informacionit që ato përmbanin, ruajtja e kampioneve të qelizave dhe profileve të ADN-se kishte një impakt më të rëndësishëm në jetën private sesa ruajtja e shenjave të gishtërinjve. Megjithatë, Gjykata konsideroi që edhe shenjat e gishtërinjve përmbajnë një informacion unik rreth individit të interesuar, dhe ruajtja e tyre pa pëlqimin e tij ose saj nuk mund të konsiderohet neutrale ose e parëndësishme. Ruajtja e shenjave të gishtërinjve, mund të sjellë në vetvete rritje të shqetësimeve në jetën private dhe kjo përbën një përplasje me të drejtën në respektimin e jetës private.

Gjykata vuri re se, bazuar në nenin 64 të aktit të vitit 1984, shenjat e gishtërinjëve ose kampionet e marra për hetimin e një individi në lidhje me një shkelje mund të ruhen edhe pasi ato e përmbushin qëllimin për të cilin ishin marrë. Si rrjedhim, ruajtja e shenjave të gishtërinjëve, kampioneve biologjike dhe profileve te ADN-së të ankuesve, bazohen në legjisllacionin vendas. Në të njëjtën kohë, neni 64 nuk ishte shumë i saktë në lidhje me kushtet e ruajtjes dhe përdorimit të informacionit personal.

Gjykata theksoi se, në këtë kontekst, ishte e domosdoshme për të pasur rregulla të qarta dhe të detajuara që tregojnë qëllimin dhe aplikimin e masave për minimumin e sigurisë. Megjithatë, në pikëpamjen e analizave dhe konkluzioneve nëse ndërhyrja ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratike, Gjykata nuk e pa të domosdoshme të vendoste nëse formulimi i nenit 64 plotësonte kërkesat e “cilësisë së ligjit” që përfshihen në nenin 8 § 2 të Konventës.

Gjykata pranoi që ruajtja e shenjave të gishtërinjëve dhe informacioni i ADN-së ushtrohej për një qëllim legjitim, që do të thotë zbulim, dhe si pasojë parandalim i krimit.

Gjykata vuri re që shenjat e gishtërinjëve, profilet e ADN-së dhe kampionet e qelizave përbënin informacion për të dhënat personale që ndodhen ne Konventën e vitit 1981 të Këshillit të Europës për mbrojtjen e individëve në lidhje me procedimin automatik të të dhënave personale.

Gjykata përcaktoi që ligji vendas duhet të lejonte sigurinë e përshtashme për të parandaluar përdorimin e të dhënave personale që mund të ishte i papajtueshëm me nenin 8 të Konventës. Gjykata theksoi se nevoja për një siguri të tillë ishte më e madhe kur mbrojtja e të dhënave personale kishte lidhje me procedimin automatik, edhe kur këto të dhëna përdoshin nga policia.

Interesat e ankuesve dhe komunitetit në tërësi për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë shenjat e gishtërinjëve dhe informacionin e ADN-së, mund të rrezoheshin përpara interesit më të madh për parandalimin e krimit. Megjithatë, vetë natyra private e këtij informacioni, kërkonte nga Gjykata të ushtronte një shqyrtim të kujdesshëm të cdo lloji mase të Shtetit që autorizon ruajtjen dhe përdorimin nga autoritetet pa pëlqimin e personave të interesuar.

Cështja që duhej të merrej në konsideratë nga Gjykata në këtë rast ishte nëse ruajtja e shenjave të gishtërinjëve dhe të dhënave të ADN-së të ankuesve, si persona që kishin qënë të dyshuar por jo të dënuar për vepra penale të caktuara, ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata mbajti në konsideratë principet bazë të instrumentave të rëndësishëm të Këshillit të Evropës si dhe ligjin dhe praktikën e Shteteve të tjera Palë, sipas të cilit ruajtja e të dhënave duhet të ishte në proporcion të drejtë me qëllimin e grumbullimit të të dhënave dhe i kufizuar në kohë. Këto principe kanë qënë zbatuar në mënyrë konsistente nga Shtetet Palë në sektorin e policisë, në përputhje me Konventën për Mbrojtjen e të Dhënave të vitit 1981 dhe rekomandimet në vazhdim nga komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.

Në mënyrë të vecantë, përse i përket kampioneve të qelizave, shumica e Shteteve Palë lejoi që këto materiale të merreshin gjatë procedimit penal për individët e dyshuar që kishin kryer një vepër të një rëndësie të caktuar. Në pjesën më të madhe të Shteteve Palë që kishin një database ADN-je funksionale, kampionet dhe profilet e ADN-së të nxjerra nga këto kampione, kërkoheshin që të dhënat të shkatërroheshin menjëherë ose brenda një periudhe të caktuar kohe pas shpalljes së pafajësisë. Disa Shtete Palë lejonin një numër të kufizuar përjashtimesh nga ky princip.

Gjykata vuri në Angli, Ëells dhe Irlanda e Veriut ishin të vetmet juridiksione të Këshillit të Evropës që lejonin ruajtjen e pa limituar në kohë të shenjave të gishtërinjëve dhe materialeve të ADN-së për cdo person, të cdo moshe, të dyshuar për cdo vepër penale të regjistruar.

Ajo vuri re që mbrojtja e parashikuar në nenin 8 të Konventës do të dobësohej në mënyrë të papranueshme në qoftë se përdorimi i teknikave moderne shkencore në sistemin e drejtësisë lejohej me cdo kusht dhe me një disbalancim të përfitimeve të mundshme të një përdorimi gjithëpërfshirës të teknikave të tilla, përkundrajt interesave të jetës private. Cdo Shtet që pretendon një rol pionier në zhvillimin e teknologjive të reja, mban përgjegjësi të vecantë për vendosjen e një balancë të drejtë në këtë këndvështrim.

Gjykata ishte habitur nga natyra arbitrare e fuqisë së ruajtjes së të dhënave në Angli dhe Wells. Në vecanti, të dhënat në fjalë mund të ruheshin pavarësisht natyrës ose seriozitetit të veprës së kryer për të cilën individit ishte dyshuar ose mosha e personit të dyshuar; ruajtja e të dhënave ishte pa limit kohor; dhe ekzistonin vetëm mundësi të kufizuara për një person të pafajshëm që ti hiqeshin të dhënat nga baza e të dhënave kombëtare ose që këto materiale të shkatërroheshin.

Gjykata shprehu një shqetësim të vecantë për riskun e stigmatizimit, kjo për faktin se personat në pozicionin e ankuesit, të cilët nuk ishin fajësuar për ndonjë krim, por ishin thirrur si të pandehur për të provuar pafajsinë, ishin trajtuar në të njëjtën mënyrë si të dënuarit. Ishte e vërtetë që ruajtja e të dhënave personale të ankuesve nuk mund të ishte e njëjtë me atë të të dyshuarve. Megjithatë, pretendimi i tyre që ata nuk ishin trajtuar si të pafajshëm ishte ngritur nga fakti se të dhënat e tyre ishin mbajtur për një kohë të papërcaktuar në të njëjtën mënyrë si personave të dyshuar, ndërkohë që të dhënat personale të personave që nuk kishin qënë asnjëherë të dyshuar për ndonjë krim ishte kërkuar që të shkatërroheshin.

Më tej Gjykata konsideroi që ruajtja e të dhënave të personave të pafajshëm mund të ishte vecanërisht e dëmshme në rastin e të miturve sikurse dhe ankuesi i parë, nisur nga situata e tyre e vecantë dhe rëndësia e zhvillimit e integritetit të tyre në shoqëri. Një vëmendje e vecantë iu kushtua mbrojtjes së të rinjve nga dëmi që mund të pësonin si pasojë e ruajtjes nga ana e autoriteteve të të dhënave të tyre personale pasi ata kishin fituar pafajsinë.

Për më tepër, Gjykata deklaroi se natyra arbitrare e fuqisë së ruajtjes së shenjave të gishtërinjve, kampioneve të qelizave dhe profileve të ADN-së të personave të dyshuar, por jo të dënuar për një krim, si në rastin e ankuesve në fjalë, dështoi në ruajtjen e një balance të drejtë midis interesave konkurruese publike dhe private, si edhe që Shteti i Paditur kishte kaluar cdo kufi të pranueshëm duke vlerësuar këtë rast. Prandaj, ruajtja në fjalë përbën një ndërhyrje të pabarabartë me të drejtën e ankuesve për respektimin e jetës private dhe nuk mund të konsiderohet e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Gjykata vendosi unanimitisht që në këtë rast kishte patur një shkelje të nenit 8.

Pretendimi për shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të KEDNJ: Duke pasur parasysh arsyetimin që çoi në konkluzionet në kuadrin e nenit 8, Gjykata vendosi unanimitisht që nuk ishte e nevojshme për të ekzaminuar më vete pretendimin në lidhje me nenin 14.

Konkluzionet në lidhje me nenin 41 të KEDNJ: Bazuar në nenin 41 të Konventës (demshperblimi i drejte), Gjykata vendosi se gjetja e një shkelje, me pasojat që mund të kishte në të ardhmen, konsiderohet si përbërës i mjaftueshëm i demshperblimit të drejtë për sa i përket dëmit moral të pretenduar nga ankuesit. Gjykata vuri re se, në përputhje me nenin 46 të Konventës, Shteti i Paditur duhet të zbatonte, nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e duhura, të përgjithshme dhe/ose të vecanta për të përmbushur detyrimet e Tij për të siguruar të drejtën e ankuesve dhe personave të tjerë në pozitë të tyre në lidhje me respektimin e jetës private. Gjykata shpërbleu ankuesit me 42.000 Euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet, minus 2.613 Euro që ishin paguar tashmë për ndihme ligjore.

Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*
Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*

Ankesa Nr: 30562/04, 30566/04
Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*
Titulli: *S. and Marper v. The United Kingdom*

Ankesa Nr: 30562/04, 30566/04
Shteti: *Mbretëria e Bashkuar*

Përgjegjës
Data e vendimit: 4 dhjetorit 2008

Organi vendimmarrës

Thelbi i vendimit

Nenent e KEDNJ: *Neni 8*
Neni 14
Neni 41

Link në HUDOC

Fjalëkyçe për kërkim në HUDOC

Jurisprudenca e cituar

Titulli: *Oneryildiz v Turkey*

ONERYILDIZ K TURQISE

Dhoma e madhe (Grand Chamber)

Ruajtja nga ana e autoriteteve e të dhënave mbi shenjat e gishtërinjëve, analizave të gjakut dhe ADN të të pandehurve edhe pasi ata janë deklaruar të pafajshëm nga gjykatat konsiderohet në shkelje të të drejtave të Konventës.

Shkelje e nenit 8
Nuk ka nevojë të ekzaminohen pretendimet e nenit 14
Akordim shpenzimesh dhe kostot
<http://cmiskp.echr.coe.int/tkp197/vieë.asp?action=html&documentId=843941&portal=hbkm&source=externalbydocnumber&table=F69A27FD8FB86142BF01C1166DEA398649>

Konkluzioni

"INTERFERENCE-{ART 8}" "MARGIN OF APPRECIATION" "NECESSARY IN A DEMOCRATIC SOCIETY-{ART 8}" "PRESCRIBED BY LAË-{ART 8}" "PREVENTION OF CRIME-{ART 8}" "PROPORTIONALITY "RESPECT FOR PRIVATE LIFE"
Amann v. Sëitserland [GC], no. 27798/95, § 56 and § 69, ECHR 2000-II ; Asan Rushiti v. Austria, no. 28389/95, § 31, 21 March 2000 ; Association for European Integration and Human Rights and Ekimdzhiev v. Bulgaria, no. 62540/00, §§ 75-77, 28 June 2007; Burghartz v. Sëitserland, 22 February 1994, § 24, and opinion of the Commission, p. 37, § 47, Series A no. 280-B ; Christine Goodëin v. the United Kingdom [GC], no. 28957/95, § 120, ECHR 2002-VI ; Connors v. the United Kingdom, no. 66746/01, § 82, 27 May 2004 ; Coster v. the United Kingdom [GC], no. 24876/94, § 104, 18 January 2001 ; Dickson v. the United Kingdom [GC], no. 44362/04, § 78, ECHR 2007 ; Evans v. the United Kingdom [GC], no. 6339/05, § 77, ECHR 2007 ; Friedl v. Austria, judgment of 31 January 1995, §§ 49-51, Series A no. 305-B, opinion of the Commission, p. 20, § 45 ; P.G. and J.H. v. the United Kingdom, no. 44787/98, § 59-60, ECHR 2001-IX ; Peck v. the United Kingdom, no. 44647/98, § 57 and § 59, ECHR 2003-I ; Rotaru v. Romania [GC], no. 28341/95, § 55 and §§ 57-59, ECHR 2000-V ; Sciacca v. Italy, no. 50774/99, § 29, ECHR 2005-I ; Scozzari and Giunta v. Italy [GC], nos. 39221/98 and 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII ; T. v. the United Kingdom [GC], no. 24724/94, §§ 75 and 85, 16 December 1999 ; Ünal Tekeli v. Turkey, no. 29865/96, § 42, ECHR 2004-X (extracts) ;

Faktet dhe pretendimet

Masallah Öneriyildiz, është një ankues me kombësi Turke i lindur në vitin 1955. Në kohën e ngjarjes ai jetonte me 12 familjarë të tij në një lagje të varfër të Stambollit. Lagjia ishte një bllok banesash të ndërtuara pa leje ndërtimi, në një zonë që prej 1970 përdorej për hedhje plehrash

nga katër Këshilla krahinash së bashku, nën mbikqyrjen dhe përgjegjësinë e Këshillit të Qytetit të Stambollit. Në një raport të shkruar në 7 Maj të vitit 1991 nga një ekspert me kërkesë të Gjykatës së Rrethit në Üsküdar, çështja e së cilës ju ishte referuar nga Këshilli i Krahinës së Ümraniye, midis të tjerash, tërhoqi vëmendjen e autoriteteve, fakti që asnjë masë nuk ishte marrë për të parandaluar shpërthimin e metanit të shkaktuar nga dekompozimi i mbeturinave në këtë zonë. Ky raport dha shkas për diskutime ndërmjet bashkiakëve të përfshirë. Megjithatë, përpara finalizimit të procedurave nga ana e autoriteteve, një shpërthim metani ndodhi në atë zonë në 28 prill të vitit 1993 dhe mbeturinat që shpërthyen nga grumbulli i plehërave gllabëruan dhjetë shtëpi që ndodheshin në këtë zonë, përfshirë dhe shtëpinë ku jetonte ankuesi i cili humbi nëntë familjarë të tij.

Pas shumë hetimesh kriminale dhe administrative për këtë çështje, bashkiakët e Ümraniye dhe Stambollit u thirrën para Trupave Gjykes përkatës, i pari sespe nuk përmbushi detyrën e tij në dhënien e urdhrin për shkatërrimin e barakave pa leje që rrethonin zonën e mbeturinave, tjetri sepse nuk kishte urdhëruar mbylljen e kësaj zone, pavarësisht nga përfundimet e raportit të ekspertit të datës 7 maj 1991.

Në 4 prill të vitit 1996 bashkiakët në fjalë u dënuan të dy për “*Pakujdesi në ushtrimin e detyrave të tyre*” dhe u gjobitën të dy me 160,000 lira Turke (TRL) dhe u dënuan me tre muaj burg bazuar në nenin 230 të Kodit Penal. Më pas vendimet ndaj tyre u konvertuan në gjoba. Më tej ankuesi depozitoi pranë Gjykatës Administrative të Stambollit, një ankesë për dëmshpërblim, në emrin e tij dhe te tre fëmijëve të tij të mbijetuar, duke i quajtur autoritetet përgjegjës për vdekjen e familjarëve dhe për shkatërrim të pronës së tij. Në gjykimin e datës 30 Nëntor të vitit 1995 autoritetet u urdhëruan ti paguanin ankuesit dhe fëmijëve të tij shumën prej 100,000,000 TRL për dëm moral dhe 10,000,000 TRL për dëm material në lidhje me shkatërrimin e pajisjeve shtëpiake (ekuivalente në atë kohë përkatësisht me 2077 EURO dhe 208 EURO). Këto shuma janë akoma për t’u paguar ankuesit, i cili nuk kishte kërkuar proces ekzekutimi.

Në GJEDNJ ankuesi pretendoi se faktet për të cilat ishte ankuar, conin në shkeljen e nenit 2 (e drejta për jetën), nenit 13 (e drejta për rekurs efektiv), nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm) dhe nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës dhe nenit 1 i Protokollit nr 1 të Konventës (mbrojtja e pronës).

Komente mbi vendimin e Dhomes se Madhe

Vendimi është shumë i rëndësishëm pasi për herë të parë Gjykata konstatoi shkelje të Konventës, neni 2, për mungesën e largëpamësisë së autoriteteve në marrjen e masave për mbrojtjen e jetës së qytetarëve nga realizimi i një katastrofe në të ardhmen si rezultat i veprime të rrezikshme të autoriteteve. Gjithashtu analiza e Gjykatës në lidhje me të drejtën e pronës është e ndryshme nga praktika e saj e deriatëhershme.

Konkretisht, GJEDNJ në analizën e pretendimeve të ankuesve theksoi se :

Neni 2-Përgjegjësia e shtetit për vdekjet: Gjykata konstatoi paraprakisht se në Turqi kishte rregulla në fuqi për sigurinë në të dy fushat e aktivitetet qendrore të çështjes së paraqitur – funksionimi i zonave të grumbullimit të mbetjeve urbane dhe rehabilitimit të zonave të varfra.

Raporti i paraqitur nga eksperti më 9 Maj të vitit 1991 i ishte referuar vecanërisht rrezikut të shpërthimit për shkak të prodhimit të metanit, “se ajo zonë nuk kishte patur mjetet e nevojshme për parandalimin e shpërthimeve të metanit që ndodhin si rezultat i dekompozimit” prej mbetjeve urbane. Gjykata vendosi se as realiteti as rëndësia e rrezikut në fjalë nuk u morën në konsideratë, duke parë që rreziku për një shpërthim kishte ekzistuar shumë më parë se të publikohej në raportin e 7 Majit të vitit 1991 dhe kështu që, vazhdimi i funksionimit në të njëjtat kushte do të conte në një rritje të rrezikut me kalimin e kohës.

Ishte e pamundur për administratën dhe departamentet e bashkisë, përgjegjëse për supervizimin dhe menaxhimin e zonës së grumbullimit të mbetjeve urbane, që të mos ishin në dijeni të rrezikut të metanit ose të masave të nevojshme parandaluese, megjithëse ekzistonin dhe rregulla të posacme në lidhje me këtë çështje. Gjykata gjithashtu vlerësoi që disa autoritete kishin patur dijeni të atyre rreziqeve, së paku që nga 27 Maji i vitit 1991, kur ato ishin vënë në dijeni nga raporti i 7 Majit të vitit 1991.

Meqënëse autoritetet Turke kishin dijeni ose duhet të ishin vënë në dijeni që ekzistonte një rrezik real për personat që jetonin afër zonës së mbetjeve urbane, ato kishin një detyrim bazuar në nenin 2 të Konventës, që të ndërmernin masa operationale, parandaluese, të nevojshme dhe të mjaftueshme për mbrojtjen e atyre individëve, vecanërisht, meqënëse ato vetë e kishin ngritur dhe autorizuar funksionimin e kësaj zone, e cila kishte cuar në këtë rrezik.

Megjithatë, Këshilli i qytetit të Stambollit jo vetëm kishte dështuar në marrjen e masave të nevojshme urgjente, por gjithashtu kishte kundërshtuar rekomandimin e Zyrës së Mjedisit pranë Kryeministrit, për ta cuar këtë zonë drejt standarteve të kërkuara. Këshilli gjithashtu, kishte kundërshtuar përpjekjet e Bashkiakut të Ümraniye të gushtit 1992, për të siguruar një urdhër nga Gjykata për mbylljen e përkohëshme të zonës së grumbullimit të mbetjeve urbane.

Megjithëse, sipas argumentimeve të Qeverisë ankuesi kishte banuar në mënyrë ilegale në zonën e mbetjeve urbane, Gjykata konstatoi se pavarësisht nga ky fakt, politika e Shtetit Turk për zonat e varfra, kishte inkurajuar integrimin e këtyre zonave në zonat urbane dhe kishte njohur kështu ekzistencën e tyre, dhe mënyrën e jetesës së qytetarëve që kishin jetuar aty që nga viti 1960, qoftë nga dëshira e tyre apo qoftë si rezultat i kësaj politike.

Në çështjen në fjalë, që nga viti 1988 deri në ditën e aksidentit të 28 Prillit 1993, ankuesi dhe të afërmit e tij kishin jetuar të pashqetësuar në shtëpinë e tyre, në një mjedis social dhe familjar që ata kishin krijuar. Gjithashtu, ishte vënë re që autoritetet kishin mbledhur taksat vendore nga ankuesi dhe banorët e tjerë të zonave të varfra të Ümraniye, dhe kishin siguruar për banorët shërbime publike për të cilat ato ishin përgjegjës. Prandaj Qeveria nuk mund të shfajësohej nga përgjegjësia për neglizhencën ndaj viktimave ose mungesës së parashikimit të këtij aksidenti.

Përsa i përket politikës në lidhje me problemet sociale, ekonomike dhe urbane në atë zonë të Stambollit, Gjykata vlerësoi që nuk ishte detyrë e saj, për ti sugjeruar pikëpamjet e saj autoriteteve lokale. Megjithatë, instalimi në kohë i sistemit të nxjerrjes së gazrave në zonën e grumbullimit të mbetjeve urbane në Ümraniye, përpara se situata të shndërrohej në një tragjedi, mund të kishte qënë një masë efektive në përputhje me legjislacionin Turk dhe praktikën e përgjithëshme në të tilla raste pa i sjellë ngarkesë të tepërt autoriteteve. Një masë e tillë mund të kishte qënë një reflektim i mirë i faktorit humanitar që Qeveria kishte aplikuar, për të justifikuar faktin që nuk ishte ndërmarrë asnjë hap për e shkatërrimin e menjëhershëm të zonave të varfra.

Më tej Gjykata konstatoi se Qeveria nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për ti ofruar banorëve të zonave të varfra informacion për rrezikun që i kanosej. Në cdo rast, edhe sikur autoritetet Turke të kishin respektuar të drejtën e informacionit ato nuk do të ishin ciluar nga përgjegjësia në mungesë të më shumë masave praktike për të shmangur rrezikun për jetën të këtyre banorëve.

Si përfundim, Gjykata konstatoi që struktura rregullatore e aplikuar në çështjen në fjalë, kishte shfaqur të meta sepse kishte lejuar hapjen dhe funksionimin e kësaj zone dhe nuk kishte patur sistem supervizimi koherent. Ajo situatë ishte përkeqësuar nga politika e përgjithshme e cila kishte qënë e pafuqishme në lidhje me çështjet e përgjithëshme të planifikimit urban dhe kishin luajtur padyshim një rol në rendin e ngjarjeve që cuan në aksidentin në fjalë. Gjykata si pasojë konkludoi që kishte patur shkelje të Neni 2.

Neni 2-Përgjegjësia e shtetit në lidhje me natyrën e investigimit: Gjykata konsideroi që kompesimi administrativ i përdorur nga ankuesi për të kërkuar dëmshpërblim nuk kishte kënaqur kërkesat për të kryer një hetim efektiv në lidhje me vdekjen e të afërmve të ankuesit që garantohet nga neni 2.

Meqënëse u përdorën kompesimet sipas ligjit penal, Gjykata vlerësoi që autoritetet investiguese konsideroheshin që kishin vepruar me përpikmëri dhe ndërsa kishin shfaqur një kujdes në kërkimin e kushteve që cuan në aksidentin e 28 Prillit të vitit 1993 dhe në vdekjen e njerëzve. Përgjegjësit e kësaj çështje u identifikuan dhe u ndoqën penalisht, dhe si përfundim u dënuan me minimumin e ndëshkimit të parashikuar nga Kodi Penal.

Megjithatë, qëllimi i vetëm i procedimit penal në çështjen në fjalë ka qënë përcaktimi nëse autoritetet mund të kishin qënë përgjegjëse për *“Pakujdesi në përmbushjen e detyrave të tyre”* bazuar në nenin 230 Kodit Penal, masa e së cilës nuk lidhej me vepra të kërcënimit të jetës ose për mbrojtjen e të drejtës së jetës brenda kuptimit të nenit 2. Gjykimi i 4 Prillit të vitit 1996 kishte lënë pezull cdo çështje në lidhje me përgjegjësinë e mundëshme të autoriteteve për vdekjen e të afërmve të ankuesit.

Prandaj, nuk mund të thuhet që sistemi i drejtësisë në Turqi kishte siguruar përgjegjësinë e plotë të zyrtarëve të Shtetit ose autoritetet për rolin e tyre në këtë tragjedi, ose zbatimin efektiv të masave të ligjit vendas që garanton respektimin e të drejtës së jetës, vecanërisht të funksionit parandalues të ligjit penal. Prandaj Gjykata vlerësoi që kishte patur një shkelje të nenit 2 në lidhje me hetimin e papërshtatshëm për vdekjen e të afërmve të ankuesit.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1-Gjykata rrëzoi argumentin e Qeverisë se autoritetet Turke për arsye humanitare kishin vendosur të mos shkatërronin shtëpinë e ankuesit edhe pse ajo ishte abuzive. Përgjegjësia kryesore e autoriteteve bazuar në nenin 1 të protokollit nr.1 i kërkon që ata të ndërmerrnin hapa praktike për të shmangur shkatërrimin e zones.

Gjykata konstatoi se fakti se ankuesi kishte pushtuar toke shteterore per 5 vjet nuk i jep atij titullin e pronarit te saj. Sipas gjykates situata ndryshon persa i perket nderteses dhe mobiljeve ne te pavaresisht faktit se ajo ishte nderuar ne menyre abuzive. Prandaj, shtepia dhe mobiljet e saj ku ankuesi e familja e tij jetonin perbejne vlere ekonomike ne kuptimin e nenit e Konventes pasi sheti per shume vite e kushte lene ankuesin ta gezonte ate duke e pranuar me veprime konkludente. Prandaj, shkaterrimi i shtepise se ankuesit u konsiderua nga Gjykata si nderhyrje ne te drejten e tij te prones ne kundërshtim me nenin 1 te Protokollit nr 1.

Më tej Gjykata vuri re që kompesimi që gjykatat Turke i caktuan ankuesit për dëm material, nuk i ishte paguar ende atij, megjithëse ishte marrë një vendim përfundimtar.

Prandaj Gjykata vendosi që kishte patur një shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1

Neni 13 në lidhje me ankesën bazuar në nenin 2: Kompesimi sipas ligjit administrativ i përdorur nga ankuesi që dukej të ishte i mjaftueshëm për të zbatuar thelbin e ankesës së tij, në lidhje me vdekjen e të afërmeve të tij, dhe kishin qene në gjendje për ti lejuar atij një korrigjim të përshtatshëm për shkeljen e gjetur tek neni 2. Megjithatë, Gjykata vlerësoi që kompesimi ishte jo efektiv në shumë aspekte dhe konsideroi që dëmshpërblimet që ju dhanë ankuesit - vetëm në lidhje me dëmet morale që lidhen me humbjen e të afërmeve të tij - në fakt nuk janë paguar asnjëherë.

Gjykata përsëriti që pagesa në kohë e kompesimit final e dhimbjes së vuajtur duhet konsideruar si një element kryesor i kompesimit bazuar në nenin 13 për një bashkshort dhe prind në zi. Gjykata më tej vuri se Gjykatës Administrative i ishin dashur 4 vjet, 11 muaj dhe 10 ditë për të marrë një vendim, një periudhë që tregon një mungesë kujdesi nga ana e tyre, vecanërisht në një situatë të dhimbshme të ankuesit. Këto arsye cuan Gjykatën në përfundimin që procedurat administrative nuk e kishin siguruar ankuesin me kompesim të dobishëm në lidhje me dështimin e Shtetit në mbrojtje e jetës së të afërmeve të tij. Prandaj Gjykata vendosi që kishte patur një shkelje të nenit 13.

Neni 13 në lidhje me ankesën bazuar në nenin 1 të Protokollit nr.1:

Sic ishte vënë re tashmë, vendimi për kompesimin ishte zgjatur në kohë dhe shuma e caktuar në lidhje me shkatërrimin e të mirave materiale nuk ishte paguar asnjëherë. Si pasojë ankuesit i ishte mohuar një kompensim efektiv në lidhje me shkeljen e pretenduar për të drejtën e tij bazuar në nenin 1 të protokollit nr.1. Prandaj Gjykata vendosi që gjithashtu kishte patur një shkelje të nenit të 13 në lidhje me këtë ankesë.

Neni 6 § 1 dhe Neni 8 :Në lidhje me përfundimet që ishin arritur deri tani, Gjykata nuk konsideroi të nevojshme ekzaminimin për deklaratën e shkeljes së Nenit 6 § 1 dhe Nenit 8.

Neni 41: Bazuar në nenin 41 (shpërblim i drejtë), Gjykata vendosi njëzëri të dëmshpërblente ankuesin me 2000 Dollarë amerikan (që korrespondojnë me rimbursimin e shpenzimeve funerale), 45,250 Euro për dëmshpërblim material dhe moral dhe 16.000 Euro për kostot dhe shpenzimet (Më pak se 3,993.84 Euro tashmë të marra nga Këshilli i Europës për ndihme ligjore). Gjykata gjithashtu i caktoi 33.750 Euro cdonjërit nga djemtë e rritur të ankuesit si kompensim për dëme morale.